



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"UKSHIN HOTI"



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"MAXHI ZEKA"



UNIVERSITETI I MITROVICËS
ISA BOLETINI



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
FEHMIAGANI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Për: Këshillin Shtetëror të Cilësisë, Agjencia e Kosovës për Akreditim

CC: Znj. Hykmete Bajrami, ministre në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Z. Naim Gashi, drejtor i Agjencisë së Kosovës për Akreditim

Nga: Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës

Lënda: Kërkesë lidhur me procesin e akreditimit institucional

13 mars 2020

Në takimim e sotëm të Konferencës së Rektorëve, mbajtur në Rektorati e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", u diskutua rreth procesit të akreditimit institucional në institucionet e arsimit të lartë në vend.

Me anë të kësaj shkrese, Konferenca e Rektorëve shpreh shqetësimin lidhur me vonesat në këtë proces të akreditimit institucional dhe të programeve nga ana e Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Me konkretisht, KSHC-ja është duke u vonuar në akreditim të ekspertëve, të cilët janë përgjegjës për akreditimin institucional dhe të programeve. Si rrjedhojë e kësaj, universitetet publike, por edhe sistemi i arsimit të lartë në vend, mund të pësoj pa fajin e universiteteve publike në këtë proces.

Me anë të kësaj shkrese, informoheni që universitetet publike kanë punuar në këtë drejtim dhe janë të përgatitura për procesin e akreditimit. Duke pasur parasysh këtë, Konferenca e Rektorëve kërkon që procedura të rrjedh pa vonesa, si dhe procesi i akreditimit të përfundoj në qershor të 2020-tës, në mënyrë që universitetet e akredituara të mund të vijojnë me rekrutimin e studentëve të rinj me kohë dhe sipas kohështrirjes së aktiviteteve zyrtare.

Shpresojmë në bashkëpunim të institucioneve të arsimit të lartë në këtë drejtim!

Me respekt,

Prof. dr. Fadil Millaku, rektori i UHZ-Pejë dhe zv. Kryesues